



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:095959

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05578862

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të B.SH., nga Gjakova , për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par .1 të KPRK-, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr..1330/22 të datës 24.04.2023 , në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **16.04.2024** , në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra dhe të akuzuarit B.SH., , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B.SH.**, nga Gjakova , Rr”.... “ nr. 61 ,i lindur me dt. ..., i biri i ...dhe i nënës Pranvera e gjinisë T..., ka të kryer shkollën e mesëm, punëtor , i gjendjes se dobët ekonomike, i pa martuar , egjiptian , shtetas i R. Kosovës, ne ID ...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- Me dt.27.09.2002 rreth orës 14:30, në Gjakovë, në Rr. ..., në ..., afër shkollës së lartë i pandehuri me dashje përdor forcë ndaj personit tjetër këtu të dëmtuarit S.B., ne atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të mëhershme që kishte pasur me vëllain e të dëmtuarit , ditën kritike pas përfundimit të ndejës së ditëlindjes që ishte duke e festuar së bashku me disa shokë tjerë , pasi që dalin nga kafeneja takohen fillimisht me vëllain e të dëmtuarit dhe fillojnë të fjalosen, të cilit edhe i drejtohen me fjalë “me ty ende nuk kemi kry punë ende”, në ato momente aty ndërhyjnë edhe i dëmtuari për ti ndarë, ku edhe goditet me grushte në pjesë të ndryshme të trupit , me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dhembje fizike dhe shqetësim emocional.

- **me çka ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,7,17,38,39,40,43,69,70 , 71 par.1 nën. par.1.1 dhe 1.3 dhe nenit 184 par.1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e gjykon :

ME DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë, në shumë prej **250.00-€ (dyqind e pesëdhjetë) euro**, të cilin dënim i pandehuri është i detyruar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **250.00-€ (dyqind e pesëdhjetë) euro**, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 12 (dymbëdhjetë) ditësh, duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi.

I dëmtuari S.B., nga fshati ...Komuna Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguajnë shpenzimet në shumë prej nga **20.00 €**, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej **20.00 €** si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

1.Ecurija e procedurës penale

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr11330/2023 të datës 24.04.2023 ka akuzuar të akuzuarin B.SH., nga Gjakova, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konstaton se me aktvendimin 2023:095959 të dt. 04.07.2023, ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qenë se i akuzuari B.SH., nuk ka marr pjesë në seancat e caktuara për të cilin është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim nga st. Policor në Gjakovë, të cilët sipas njoftimit me nr. ref. 04/1-08-Gj-S-153/23 të dt. 04.07.2023, jemi njoftuar se i njëjti është kërkuar në adresën e dhënë por i njëjti nuk është gjetur, është kontaktuar edhe me banorin e kësaj lagje U.H., me nr. tel 044-129-413, dhe deklaroi se ky person është i panjohur në këtë adresë, andaj për të njëjtin ka lëshuar edhe urdhër arrest.

I akuzuari B.SH., është ndaluar nga st. Policor lidhur me urdhër arrestin e lëshuar nga ana e kësaj gjykate, dhe i njëjti është sjellë në gjykate sot me dt. 16.04.2024, i njëjti do të procedohet dhe gjykata bënë tërheqja e urdhër arrestit.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 16.04.2024, lexon aktakuzën PP/II.nr11330/2023 të datës 24.04.2023 dhe deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari B.SH., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaroi: se ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë, shtoj se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam pënduar për veprën e kryer në efekt, pasi që edhe unë jam sulmuar nga ai, kërkojë falje nga i dëmtuari, me të njëjtin me parë nuk kam probleme e as pas këtij rasti, andaj gjykatës i propozoi që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kërkim falje publike në gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike, të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Qazim Xharra ,deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuari pasi qe ky pranim i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimi te tillë , pranim është bere pas sqarimit të mjaftueshëm nga ana e gjykatës, po ashtu faktin se pranim i fajësisë mbështet në faktet e çështjes ,respektivisht provave materiale dhe personale qe përmban aktakuza.Lidhur me vendimin për dënim i propozon gjykatës që si rrethana lehtësuese të merret pranimin e fajësisë për veprën penale me te cilën akuzohet , ndërsa si rrethanë renduese të këtë parasysht dashjen e kryerjes se veprës penale .

2.Vlersimi pranimi të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari B.SH., , për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së , ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë pas sqarimit të mjaftueshëm edhe nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë , pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykon në bazë të ligjit ,me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij .

4. Elementet e veprës penale

Sipas nenit 184 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Sulm e kryen: “ 1. Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin B.SH., , e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin konstaton faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, peshën e veprës penale, dashjen e kryerjes së veprës penale ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se njëjtë është i moshës relativisht të re, punëtor. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, sjelljen tejet korrekte në gjykatë, shprehjen e keq ardhjes për rastin që i ka ndodhur, kërkim falja publike, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet si dhe fakti se nga se Evidenca penale PDP për të akuzuarin, nuk ka të kaluar kriminale, aktvendim apo aktgjykim të formës së prerë dhe pas këtij rasti është inicuar ndonjë rast tjetër. Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se me shqiptimi i dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i tij, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston me parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprës penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, si dhe ti tërhiqet vërejtja me kërcënimin e dënimit, për të ndaluar të mos kryej vepër penale.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin S.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimin duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nën. par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal
2023:095959 datë 16.04.2024

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.